# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-461565**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përshkallëzohen protestat në Kosovë, paralajmërohet tubim kombëtar më 1 tetor kundër dënimeve të ish-liderëve të UÇK |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/pershkallezohen-protestat-ne-kosove-paralajmerohet-tubim-kombetar-me-1-te-i105510` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:04:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 18:31:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ebfa9001e1b4590f2f172479f36b8470719df314ed323e3cab4412621774727d` |
| TEKSTI | `090b453833d0a77617f09609c89372bc17c66ac5a13bc14d18829cbc32ca46fb` |
| PAMJA | `2ed76660727f13e48d608166e03403d72009ee1bc2ea3d4076d956af00caaa68` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `36e539cfce7b3160e833bcbe2ccd9656d645f9b6d34495d9cda186c2f9303dc1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/36e539cfce7b3160e833bcbe2ccd9656d645f9b6d34495d9cda186c2f9303dc1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Përshkallëzohen protestat në Kosovë, paralajmërohet tubim kombëtar më 1 tetor kundër dënimeve të ish-liderëve të UÇK

Piranjat Përditësimi i fundit 22 Shtator 2026, 20:31



Në kundërshtim të aktgjykimit të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tash e një javë po protestohet në qytete të ndryshme.

Megjithatë, kjo formë e kundërshtimit nga qytetarët, ndaj vendimit që e quajnë të padrejtë të Hagës, do të intensifikohet në ditët në vazhdim. Iniciativa qytetare "Liria ka emër" do të organizojë marsh gjithë popullor më 1 tetor në Prishtinë që korrespondon me protestat e studentëve në 1997 dhe më 10 tetor në Bruksel.

"Atëherë kërkuam liri, jetë më të mirë për popullin e Kosovës. Më tetor tani kërkojmë liri për çlirimtarët tanë. Ne do dalim bashkë, paqësisht me një mesazh të përbashkët, "Jo në emrin tim". Më 10 tetor kjo thirrje do të vazhdojë tutje në Bruksel së bashku me mërgatën tonë", tha Eliza Hoxha-iniciativa "Liria ka emër".

Krahas kësaj, "Liria ka emër" ka iniciuar edhe peticion qytetar që thonë se do ta dorëzojë simbolikisht në Bruksel, Strasburg dhe Hagë.

"Nënshkrimet do t'i dërgojmë simbolikisht në Bruksel, Strasburg dhe në Hagë si shprehje e qëndrimit të qytetarëve të Kosovës që zgjedhin të bashkohen karshi historisë së përbashkët".

Përfaqësuesi i "Liria ka emër", Ismail Tasholli ka bërë thirrje për unitet, duke kërkuar edhe veprim institucional.

"Qeveria duhet të na tregojë qartë cili është plani, cila është strategjia shtetërore, çfarë mbështetjeje juridike dhe financiare ofrohet, çka do të bëjë diplomacia e Kosovës, si duhet të angazhohen institucionet akademike dhe ekspertët ndërkombëtarë", u shpreh Ismail Tasholli – iniciativa "Liria ka emër".

Edhe veteranët e luftës do të vazhdojnë protestat. Më 25 shtator, në të gjitha qytetet e Kosovës, degët përkatëse të Organizatës së Veteranëve të Luftës do të mbajnë protesta në orën 17:00, me përjashtim të Prishtinës, të cilët do i bashkohen protestës që mbahet në orën 21:00.

Reagimi institucional në Kosovë tash e një javë mungon, ndërkohë që Partia Demokratike e Kosovës ka iniciuar në Kuvend projektligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Speciale, derisa një seancë akoma nuk është caktuar.

Më 16 shtator, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë dënuan për krime lufte Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin.

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 22 Shtator20:29

### [Kurti pas takimit me kryeministrin e Kroacisë: Aktgjykimi i Speciales është i pasaktë, i padrejtë dhe i rëndë]

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti përmes një postimi në "Facebook" ka ndarë detaje lidhur me takimin e tij të zhvill...

KOSOVA 22 Shtator19:13

### [Endrit Thaçi 'thyen' rrjetin, emri i djalit të ish-liderit të UÇK-së, më i kërkuari në Google]

Eksperte e IT, Nadia Elbasani ka treguar se ditën e vendimit të Hagës për ish-liderët e UÇK-së, emri i djalit të Ha...

Eksperja e TI, Nadia Elbasani ka treguar se ditën e vendimit të Hagës për ish-liderët e UÇK-së, emri i djalit të Ha...

KOSOVA 22 Shtator13:27

**“Zëri ynë të dëgjohet fuqishëm”, Diaspora në Gjermani e Finlandë në këmbë për Çlirimtarët**

Më 26 shtator, në Ulmë të Gjermanisë dhe në Kansalaistori të Helsinkit në Finlandë, do të organizohen protes...

KOSOVA 22 Shtator09:49

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ Haxhiu kërkon unitet dhe bashkërendim për hapat pas aktgjykimit të Speciales**

Pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së, në Kosovë po kërkohet unitet dhe bashkëre...

KOSOVA 22 Shtator09:20

**Kosovë/ Nismë për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale**

Njëra nga partitë më të mëdha opozitare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës, PDK, procedoi në Kuvend projektl...

KOSOVA 22 Shtator08:48

**Avokati i Hashim Thaçit: Tre gjykatësit e Speciales e njollosën UÇK-në dhe NATO-n**

Avokati i Hashim Thaçit, Pierre-Richard Prosper, ka deklaruar për mediat në Kosovë se aktgjykimi i Dhomave të Specializuara nuk god...

KOSOVA 21 Shtator23:58

**Nata e gjashtë/ Pjesëmarrje e madhe në mbështetje të drejtuesve të UÇK-së**

Nata e gjashtë e protestës në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit është p&e...

KOSOVA 21 Shtator22:56

**Altin Krasniqi flet për bisedën me babain në Hagë pas vendimit të gjykatës**

Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, ka folur për gjendjen e babait të tij pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. I...

KOSOVA 21 Shtator22:07

**“Këpuca është vënë në këmbën e gabuar”/ Avokati i Thaçit: Vendimi i Speciales nuk ishte i ndershëm, është larg së vërtetës**

Pierre Richard Prosper, avokat i ekipit mbrojtës të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka komentuar vendimin e Gjykatës S...

KOSOVA 21 Shtator21:13

**Ish-ambasadori i SHBA flet për pasojat nëse Kosova kërkon të zhbëjë Gjykatën Speciale të Hagës**

Ish-ambasadori amerikan, Christopher Hill në një lidhje live në emisionin “Now” me Erla Mëhillin në Euronews Albania ka fol...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 22 Shtator

**Shkuan për t’i blerë dhuratën të ëmës për ditël...**

Tri motra humbën jetën pasi një zjarr përfshiu një qendër tregtare, duke detyruar klientët e tmerruar të hidheshin nga d...

AKTUALITET 22 Shtator

**Aksioni i SPAK/ Kontrolle dhe në bazat e Tropli...**

Të tjera detaje kanë dalë në dritë nga operacioni i SPAK, i ndërmarrë paraditen e kësaj të marte. Raportohet se ...

AKTUALITET 22 Shtator

**A është cenuar siguria kombëtare? SPAK lëshoi “...**

SPAK lëshoi sot masën e sigurisë ‘arrest shtëpie’ për kreun e SHISH, Vlora Hyseni, e cila po hetohet për skandalin e...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

**Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës**

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

**video**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.